



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:242459

Datë: 03.09.2024

Numri i dokumentit: 06117675

C.nr.308/2019

PROCESVERBAL I SEANCËS PËRGATITORE

I përpiluar më datë 03.09.2024, në GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil në çështjen juridike të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit - Prishtinë të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.G. kundër të paditurit G.B. , me objekt kontesti rimbursim dëmi.

P r e z e n t:

Gjyqtari:
Leotrim Gashi

Për paditësen
B.G. sipas autorizimit

Zyrtare ligjore
Liridona Bajrami

Për të paditurin:
G.B.

Pyeten palët se a kanë vërejtje në përbërjen e gjykatës:

Pa vërejtje nga palët.

Seanca është publike

Filloj ne ora 14:40, për shkak të një seance paraprake

Gjyqtari i çështjes e hap shqyrtimin mbi këtë çështje, e publikon lëndën e shqyrtimit dhe konstaton se në këtë seancë prezent është përfaqësuesja e autorizuar e paditëses dhe i padituri G.B.

Andaj gjykata konstaton se ka kushte ligjore për mbajtjen e seancës, e si rrjedhojë merr:

A K T V E N D I M

Seanca e sotme mbahet dhe e njëjta është publike.

Gjykata i njofton palët prezente se duhet të mbajnë rendin dhe qetësinë në gjykatë dhe nuk duhet të flasin derisa gjykata të iu jap fjalën, për prishje të rendit dhe qetësisë në seancë gjyqësore, gjykata mund që duke u bazuar në nenin 289.2 të LPK-së, fillimisht do t'i qortojë palët dhe nëse kjo rezulton të jetë e pasuksesshme mundet që ti largoj nga salla dhe t'iu shqiptojë gjobë deri në 500 euro.

Gjykata i njofton palët së në këtë seancë përgatitore duhet të parashtrojnë të gjitha faktet në të cilat mbështesin kërkesat e tyre si dhe të propozojnë të gjitha provat më të cilat pretendojnë të vërtetojnë faktet e tilla.

Gjykata i njofton palët se kontestin mund ta zgjidhin edhe në procedurën e ndërmjetësimit, në pajtim me nenin 411 të LPK – së si dhe me anë të pajtimit gjyqësor siç parashihet në nenin 412 të LPK – së.

Lidhur me mundësinë e zgjidhjes së këtij kontesti përmes procedurës së ndërmjetësimit apo arritjes së pajtimit gjyqësor, përfaqësuesja e paditësit, deklaron:

Jemi të gatshëm që këtë çështje ta përfundojmë me marrëveshje gjyqësore

Lidhur me mundësinë e zgjidhjes së këtij kontesti përmes procedurës së ndërmjetësimit apo arritjes së pajtimit gjyqësor, i padituri deklaron:

Pajtohem që të arrijmë marrëveshje.

Palët ndërgjyqëse deklarojnë se kanë arritur pajtim gjyqësor dhe i propozojnë gjykatës që ta aprovojë këtë:

PAJTIM GJYQËSOR

- I. DETYROHET i padituri G.B., që në emër të shkaktimit të dëmit, në aksidentin e datës 25.04.2017, të ia paguajë paditëses BKS shumën prej 140 euro, dhe atë në dy këste mujore, me nga 70 euro në muaj të cilat shuma duhet t'i paguajë nga data 20

deri 25 të muajit shtator 2024 dhe nga 20 deri 25 të muajit tetor të vitit 2024, në xhirollogarinë e paditëses me numër ... në bankën private të biznesit (BPB).

- II. Paditësja heq dorë nga kamata ligjore dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata në bazë të nenit 411 dhe 412 të LPK –së, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pajtimi gjyqësor, i lartpropozuar nga ana e palëve ndërgjyqëse.
- II. Ky pajtim paraqet titull ekzekutiv dhe mund të goditet vetëm me padi.

Procesverbali pasi u dëgjua me zë i njëjti edhe u nënshkrua pa vërejtje.

Përfundoi në ora: 14:52 minuta.

Përfaqësuesja e paditëses

I padituri

V ë r t e t o j n ë

Zyrtarja ligjore

G j y q t a r i